



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**  
**SEKTORI I PROKURIMEVE**

Nr. \_\_\_\_\_prot.

Durrës, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**(PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

[25.04.2023]

Drejtuar: BALILI KONSTRUKSION + AGBES KONSTRUKSION me NIPT K17016202S + NIPT K32807432W me adrese: Vlore VELCE + Fier SHEQ I MADH

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e Hapur, Punë”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-59060-02-14-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rehabilitimi i zonës që preket nga zgjerimi territorial i varrezave të qytetit të Durrësit”

**Fondi limit:** 240’000’000 (dyqind e dyzetë milion) lekë pa TVSH

**Kohëzgjatja e kontratës:** 720 (ditë)

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [20 shkurt 2023] [17]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BE - IS me NIPT K71412003A + CURRI me NIPT J67902718S, me vlerë të ofertës 203’812’665 (dyqind e tre milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë.
2. BALILI KONSTRUKSION me NIPT K17016202S + AGBES KONSTRUKSION me NIPT K32807432W, me vlerë të ofertës 231’059’829 (dyqind e tridhjetë e një milion e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzetë e nëntë) lekë.
3. ALKO IMPEX CONSTRUCTION me NIPT K91628013D, me vlerë të ofertës 236’905’975 (dyqind e tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë

4. A.L-ASFALT me NIPT K81511508A + EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI me NIPT K91727010A, me vlerë të ofertës 238'700'543 (dyqind e tridhjetë e tetë milion e shtatëqind mijë e pesëqind e dyzetë e tre) lekë
5. 2 T me NIPT K01731001M, me vlerë të ofertës 239'708'175 (dyqind e tridhjetë e nëntë milion e shtatëqind e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. Për ofertuesin BE - IS me NIPT K71412003A + CURRI me NIPT J67902718S**, me vlerë të ofertës **203'812'665 lekë**, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **BE - IS + CURRI**:

1. Nuk përmbush piken 2.3.g.8 të Kapacitetit Teknik për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të kerkuara, pasi referuar formularit përmbledhës së vetedeklarimit të paraqitur nga BOE, konstatohet se BE - IS + CURRI nuk ka vetedeklaruar *“Agregat hidraulik për pastrim vegjetacioni e bimesie d~10 cm (krah hidraulik decespugliator me peshe jo më pak se 150 kg)”*.

Referuar vetedeklarimeve të bera nga ofertuesi, është vetedeklaruar aparat teknologjik për pastrime me targe TR8829R, në përmbushje të pikës 2.3.g.20 të Kapacitetit Teknik për disponimin e *“Automjet teknologjik për pastrimin e kolektorëve të bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartes (2-4 ton), me ndarje membranë të lëvizshme (ndryshim volumi ujë/material i ngurtë), e pajisur me pompë pastrimi me presion pune, jo më pak se 200 bar, prurje jo më pak se 60 litra/minut dhe dy sonda me gjatësi më të madhe se 70 m, e pajisur me pompë vakumi për thithjen e materialeve të ngurta”*.

Pra, për mjetet e pastrimit është vetedeklaruar 1 mjet nga 2 të kerkuar.

2. Nuk përmbush piken 2.3.g.21 të Kapacitetit Teknik për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të kerkuara, pasi referuar formularit përmbledhës së vetedeklarimit të paraqitur nga BOE, konstatohet se BE - IS + CURRI nuk ka vetedeklaruar *“Automjet teknologjik për inspektimin e kolektorëve me diametër (250÷600) mm e pajisur me sisteme kamerash”*.

3. Nuk përmbush piken 2.3.g.23 të Kapacitetit Teknik për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të kerkuara, pasi referuar formularit përmbledhës së vetedeklarimit të paraqitur nga BOE, konstatohet se BE - IS + CURRI nuk ka vetedeklaruar *“Makineri për ndërtim mikrotunel D=110mm me lazer, për kalim tubi poshtë rruges”*.

Punimet si më lart prej 52 ml janë marrë persiper nga subjekti CURRI, i cili ka deklaruar makinë shpimi horizontale për shpime nën asfalt (2 cope), dhe makinë vetëvizuese për shpime horizontale të kompletuar (1 cope), të marra me qera në datën 05.04.2019, me afat 4 vjet (datë 04.04.2023). Referuar grafikut të punimeve të paraqitur, afati për zbatimin e këtyre punimeve është 5 muaj, përtej afatit të perfundimit të kontratës së qerës për këto mjete.

4. Nuk përmbush piken 1.dh) të Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, ku citohet se *“nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së”*, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se subjekti BE-IS ka detyrime në pagesën e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore në vlerën 1,437,788 leke, sipas vërtetimit Nr. T07821121 të leshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukes, në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 76, pika 2, ku përcaktohet se *“Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave*

ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur: a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi; b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit; c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh; ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkëljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës”.

**2. Për ofertuesin ALKO IMPEX CONSTRUCTION me NIPT K91628013D, me vlerë të ofertës 236’905’975 lekë, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik ALKO IMPEX CONSTRUCTION:**

1. Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes se kerkuar.

2. Nuk përmbush piken 2.3.a të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 120’000’000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 480’000’000 lekë. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”, pasi pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në përmbushje të këtij kriteri, nuk plotësohet vlera minimale e kërkuar në pikat a) dhe b).

3. Nuk përmbush piken 2.3.b të Kapacitetit Teknik për kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë për zbatimin e punimeve objekt kontrate, pasi nuk disponon kategorinë NS 8-A (Ndërtimë parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri).

4. Nuk përmbush piken 2.3.c të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë: Inxhinier Ndërtimi 1(një); Inxhinier Gjeoteknik 1(një); Inxhinier Gjeoded 1(një); Inxhinier Hidroteknik 1(një); Inxhinier Mjedisi 1(një)”, pasi në përmbushje të këtij kriteri nuk ka paraqitur Inxhinier Gjeoteknik 1(një); Inxhinier Gjeoded 1(një); Inxhinier Hidroteknik 1(një); Inxhinier Mjedisi 1(një).

5. Nuk përmbush piken 2.3.d të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë: Inxhinier Ndërtimi 1 (një); Inxhinier Hidroteknik 1 (një); Inxhinier Mekanik 1 (një); Teknik Ndërtimi 2 (dy); Punonjes 1 (nje), pajisur me certifikatë për "Ekspert për ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplomë/certifikatë si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të muajit të fundit; Punonjes 1 (nje), pajisur me certifikatë për "Përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë

*individuale pune të vlefshme, diplome/certifikate si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë; Mjek Epidemiolog 1 (nje) për mbikqyrjen e kryerjes së punimeve për përforcim e rikonstruksion varreza ekzistuese në zonat me rrëshqitje aktive (në mbështetje të VKM Nr. 711, datë 29.10.2014 dhe Udhëzimit Nr. 4, datë 9.12.2015), shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplomë mjeku /specializim, të figurojë në listëpagesat e shoqërisë; Puntorë te thjeshte 15 (pesëmbëdhjetë)”, pasi ne permbushje te ketij kriteri ka paraqitur vetem staf mbeshtetes inxhinier mekanik, teknik ndertimi (1 nga 2 te kerkuar), dhe mjek.*

6. Nuk permbush piken 2.3.e te Kapacitetit Teknik, ku citohet se “*Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: Manovratorë për mjete ndërtimi 2 (dy); Drejtues Mjeti 2 (dy); Murator 2 (dy); Hekurkthyes 2 (dy); Saldator 1 (nje); Hidraulik 1 (nje)*”, pasi ne permbushje te ketij kriteri ka deklaruar 1 hekurkthyes nga 2 te kerkuar.

7. Nuk permbush piken 2.3.g te Kapacitetit Teknik per disponimin e mjeteve dhe pajisjeve, me konkretisht pikat 1, 3, 4, 5, 6, 8, 11, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, pasi nuk ka vetedeklaruar asnje nga mjetet dhe pajisjet e kerkuara sipas pikave te mesiperme.

**3. Për ofertuesin A.L-ASFALT me NIPT K81511508A + EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI me NIPT K91727010A, me vlerë të ofertës 238’700’543 lekë, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, nepermjet anetareve Bledar Metalla dhe Marsida Balla, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterëve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik A.L-ASFALT + EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI:**

1. Nuk permbush Kapacitetin Teknik pika 2.3.g.(8,19,20,21,22,23) pasi: **OE “EUROKOS HOLDING”** sh.p.k. Dega ne Shqiperi nuk ka deklaruar kapacitetet teknike te nevojshme per kryerjen e punimevete mara persiper ne aktmareveshjen e bashkepunimit, perkatesisht: A.L-ASFALT shpk **60 %**, “EUROKOS HOLDING” sh.p.k. Dega ne Shqiperi **40 %**, per cdo ze ne preventivin e punimeve ku:

**- Mungon kapaciteti teknik 2.3.G.8, “8.** Agregat hidraulik per pastrim vegjetacioni e bimesie d~10 cm (krah hidraulik decespugliator me peshe jo me pak se 150 kg)” per realizimin e “Prerje bime te vogla Ø-10cm me agregat hidraulik (decespugliator)”;

**- Mungon kapaciteti teknik 2.3.G.19, “19.** Automjet teknologjik për pastrimin e kolektoreve të bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartës (9-12 ton), me ndarje membranë të lëvizshme (ndryshim volumi uje/material i ngurtë), e pajisur me pompë pastrimi me presion pune jo më pak se 170 bar, prurje jo me pak se 330 litra/minut dhe dy sonda me gjatesi me te madhe se 80m, e pajisur me pompe vakumi per thithjen e materialeve te ngurta me kapacitet jo me te vogel se 1500 m3/ore.” per realizimin e “Pastrim kolektori Ø (250 ÷ 600) me automjet teknologjik per pastrimin e kolektoreve” dhe “Trasport i llumit me automjet teknologjik deri ne 5 km”;

**- Mungon kapaciteti teknik 2.3.G.20, “20.** Automjet teknologjik për pastrimin e kolektorëve të bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartës (2-4 ton), me ndarje membranë të lëvizshme (ndryshim volumi ujë/material i ngurtë), e pajisur me pompë pastrimi me presion pune, jo më pak se 200 bar, prurje jo më pak se 60 litra/minut dhe dy sonda me gjatësi më të madhe se 70 m, e pajisur me pompë vakumi për thithjen e materialeve të ngurta” per realizimin e “Pastrim kolektori Ø (250 ÷ 600) me automjet teknologjik per pastrimin e kolektoreve” dhe “Trasport i llumit me automjet teknologjik deri ne 5 km”;

- **Mungon kapaciteti teknik 2.3. G.21, “21.** Automjet teknologjik për inspektimin e kolektorëve me diametër (250÷600) mm e pajisur me sisteme kamerash” për realizimin e inspektimit punimeve të kryera “Pastrim kolektori Ø (250 ÷ 600) me automjet teknologjik për pastrimin e kolektoreve”;

- **Mungon kapaciteti teknik 2.3.G.22, “22.** Makine shpimi horizontale për instalim tubi me çarje për zëvendësim kolektorësh ekzistues Ø (250 ÷ 600), (Pipe bursting)” për realizimin e inspektimit punimeve të kryera “Instalim tubi me çarje për zëvendësim kolektorësh ekzistues Ø (250 ÷ 600), (Pipe bursting)”;

- **Kapaciteti teknik 2.3.G.23, “23.** Makineri për ndërtim mikrotunel D=110mm me lazer, për kalim tubi poshtë rruges.” për realizimin e inspektimit punimeve të kryera “Mikrotunel D=110 mm, poshtë rruges për kalimin e tubit të polietilenit PEHD+ rakorderi, për lidhjen e rrjetit të ri të ujësjes në rrjetin ekzistues”.

2. Nuk përmbush piken 2.3.j të Kapacitetit Teknik ku citohet se “*Operatori ekonomik në konkurim duhet të jetë i pajisur me licencë nga Qendra Kombëtare e licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”, pasi subjekti EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI ka marrë persiper 40% të të gjithë zerave të preventivit, dhe nuk ka paraqitur licencën përkatëse të sipërcituar.*

**4. Për ofertuesin 2 T me NIPT K01731001M, me vlerë të ofertës 239’708’175 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik 2T:**

1. Nuk përmbush piken 2.3.g.14 dhe 2.3.g.15 të Kapacitetit Teknik për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të kerkuara, ku citohet “*Autobetoniere vetngarkuese me peshe jo më të vogël se 5.5 ton - cope 2; Autobetoniere vetngarkuese me peshe jo më të vogël se 5.5 ton – cope 2*”, pasi në përmbushje të këtij kriteri, ka vetdeklaruar në total 2 mjete nga 4 të kerkuara.

2. Nuk përmbush piken 2.3.g.19 të Kapacitetit Teknik për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të kerkuara, ku citohet “*Automjet teknologjik për pastrimin e kolektoreve të bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartës (9-12 ton), me ndarje membranë të lëvizshme (ndryshim volumi ujë/material i ngurtë), e pajisur me pompë pastrimi me presion pune jo më pak se 170 bar, prurje jo më pak se 330 litra/minut dhe dy sonda me gjatësi me të madhe se 80m, e pajisur me pompe vakumi për thithjen e materialeve të ngurta me kapacitet jo më të vogël se 1500 m<sup>3</sup>/ore - cope I*”, pasi nuk ka vetdeklaruar asnjë mjet në përmbushje të këtij kriteri.

3. Nuk përmbush piken 2.3.g.20 të Kapacitetit Teknik për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të kerkuara, ku citohet “*Automjet teknologjik për pastrimin e kolektorëve të bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartës (2-4 ton), me ndarje membranë të lëvizshme (ndryshim volumi ujë/material i ngurtë), e pajisur me pompë pastrimi me presion pune, jo më pak se 200 bar, prurje jo më pak se 60 litra/minut dhe dy sonda me gjatësi më të madhe se 70 m, e pajisur me pompë vakumi për thithjen e materialeve të ngurta - cope I*”, pasi nuk ka vetdeklaruar asnjë mjet në përmbushje të këtij kriteri.

4. Nuk përmbush piken 2.3.g.21 të Kapacitetit Teknik për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të kerkuara, ku citohet “*Automjet teknologjik për inspektimin e kolektorëve me diametër (250÷600) mm e pajisur me sisteme kamerash - cope I*”, pasi nuk ka vetdeklaruar asnjë mjet në përmbushje të këtij kriteri.

5. Nuk permbush piken 2.3.g.22 te Kapacitetit Teknik per disponimin e mjeteve dhe pajisjeve te kerkuara, ku citohet “*Makine shpimi horizontale per instalim tubi me carje per zevendesim kolektorësh ekzistues Ø (250 ÷ 600), (Pipe bursting) - cope I*”, pasi nuk ka vetdeklaruar asnje mjet ne permbushje te ketij kriteri.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [BALILI KONSTRUKSION + AGBES KONSTRUKSION me adresë Vlore VELCE + Fier SHEQ I MADH, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 231’059’829 (dyqind e tridhjetë e një milion e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet e nëntë) lekë / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkia Durrës, Njësia e Prokurimit, *njesia.prokurimeve@durres.gov.al*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [NUK KA TE KLASIFIKUAR TJETER PERVEC KETIJ OPERATORI], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**Emiriana Sako**

Konceptoi: *A.Troci*

Pranoi: *A.Xhelilaj*

Miratoi: *A.Iljazaj*

*Nr.Kopjeve:2*

*Datë:25.04.2023*